



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – PLANI I ORAREVE TË RENDEVE TË UDHËTIMIT PËR LINJAT E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT 2024-2028

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Plani i i orareve të rendeve të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2024-2028.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Drejtoratit për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ose në email adresën burim.rrustemi@rks-gov.net, më së largu me datë 18.07.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 345/01-31690
Lipjan, më 03.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan, Br. 15-353-35739 dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT- AKCION PLAN I RASPORED POLAZAKA
LINIJA PUTNIČKOG AUTOBUSKOG PREVOZA NA TERITORIJI OPŠTINE LIPLJAN
2024-2028

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- Akcion Plan i raspored polazaka linija putničkog autobusnog prevoza na teritoriji Opštine Lipljan 2024-2028.

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Akcion Plan mogu se poslati Uprava za javne službe zaštite i spasavanja na email adresu: burim.rrustemi@rks-gov.net naj kasnije do 18.07.2024.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 345/01-31690
Lipljan, 03.07.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**Dokument konsultimi për PLANIN
E ORAREVE TË RENDEVE TË UDHËTIMEVE PËR LINJAT E TRANSPORTIT TË
UDHËTARËVE ME AUTOBUS NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT 2024-
2028 Nr. _____**

Qëllimi i konsultimit

Përmes konsultimit publik synohet të merren propozimet konkrete për PLANIN E ORAREVE TË RENDEVE TË UDHËTIMEVE PËR LINJAT E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT 2024-2028 Nr. _____ nga qytetarët dhe operatorët të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit.

Pas përmbylljes së procesit të konsultimit publik, të gjitha propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet e pranuar, do të shqyrtohen nga Komuna, ku si rezultat i shqyrtimit të kontributeve dhe rekomandimeve të konsultimit do të hartohet dhe publikohet raporti për rezultatet e procesit të konsultimit publik. Në raportin e konsultimit publik, do të jepen informatat për secilin koment apo rekomandim që është marrë parasysh, si dhe sqarime apo arsyetimet për secilin koment që nuk është marrë në konsideratë.

Afati përfundimtar për dorëzimin e përgjigjeve

Afati përfundimtar i dorëzimit të kontributit me shkrim në kuadër të këtij procesi të konsultimit publik është nga _____ deri më _____.

Të gjitha komentet e pranuar deri në këtë afat do të përmbliidhen nga ana e Komunës. Të gjitha kontributet me shkrim duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: burim.rrustemi@rks-gov.net me titull PLANI I ORAREVE TË RENDEVE TË UDHËTIMEVE PËR LINJAT E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT 2024-2028 Nr. _____

Ju lutemi që në kuadër të kontributit tuaj me shkrim, të specifikoni qartë së në çfarë cilësie jeni duke kontribuar në këtë proces konsultimi (p.sh. në cilësi të qytetarit – udhëtarit, përfaqësuesit të ndonjë organizate, kompanisë, etj.)

Komentet nga palët

Ju lutem, që komentet tuaja të ofrohen sipas udhëzimeve të shënuara më poshtë:

Emri i palës që jep komente:

Arsyeja e propozimit-rekomandimit:

Informatat e kontaktit (adresa, e-mail, telefoni):

Data e dërgimit të komenteve: